

GJYKATA E APELIT

Numri i rastit: PAKR 1/2017

(Pkr nr. 218/14 GjTh Prishtinë)

Data: **19 Tetor 2017**

Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, kryetare dhe raportuese, gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska Gallant dhe gjyqtarja e gjykatës së apelit Mejreme Memaj, si anëtarë të kolegjit, me ndihmën e këshilltares ligjore të EULEX-it Vjollca Kroci-Gerxhaliu, duke vepruar si procesmbajtëse dhe në seancat e hapura më 6 shtator 2017;

I pandehuri:

E. S., nga babai xxx, i lindur më xxx në xxx, në paraburgim që nga arrestimi i tij më xxx;

I ngarkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale PPS nr. 467/2009 të datës 24 prill 2014, të ndryshuar më 27 prill 2016 me: pika 1: Vepra penale e *Shtytjes për kryerjen e vrasjes së rëndë* në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK); pika 2: Vepra penale e *Detyrimit* në kundërshtim me nenin 267 (1) dhe (2) të KPPK-së dhe pika 3: Vepra penale e *Dhunimit* në kundërshtim me nenin 193 (1) dhe (2) KPPK-së:

i shpallur fajtor sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës Pkr. nr. 218/14 të datës 17 maj 2016 për pikën numër një: Vepra penale e *Shtytjes për kryerjen e vrasjes së rëndë* në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPPK-së; dhe pikën numër dy: Vepra penale e *Detyrimit* në kundërshtim me nenin 267 dhe i dënuar me dënimin unik me burgim afatgjatë prej 37 (tridhjetë e shtatë) vitesh;

duke vepruar sipas ankesave të avokatit mbrojtës K.K. të parashtruar më 9 dhjetor 2016 dhe ankesës së avokatit mbrojtës B. P. më 8 dhjetor 2016, të dyja të paraqitura në emër të të pandehurit **E.S.** kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Pkr. nr. 218/14 të datës 17 maj 2016;

pas shqyrtimit të përgjigjeve ndaj ankesave të avokatëve mbrojtës, të parashtruar veçmas nga Prokurori Special i EULEX-it më 29 dhjetor 2016;

pas shqyrtimit të propozimit të Prokurorisë së Apelit të Kosovës nr. PPA/I. Nr. 13/2017 të parashtruar më 20 mars 2017;

pas këshillimit dhe votimit më 7 shtator 2017 dhe 19 tetor 2017;
sipas nenit 398 të KPPRK-së, nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e avokatit mbrojtës K.K. e parashtruar më 9 dhjetor 2016 dhe ankesa e avokatit mbrojtës B.P. e paraqitur më 8 dhjetor 2016, të dyja të paraqitura në emër të të pandehurit E.S. në lidhje me pikën një, aprovohen pjesërisht;**
- II. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës Pkr. nr. 218/14 të datës 17 maj 2016 në pjesën lidhur me veprën penale të Shtytjes për kryerjen e vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPPK-së (pika një) anulohet dhe rasti kthehet në rigjykim për këtë pikë të aktakuzës;**
- III. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës Pkr nr. 218/14 të datës 17 maj 2016 në lidhje me veprën penale të Detyrimit sipas paragrafit (1) të nenit 267 të KPPK-së (pika dy), ndryshohet si në vijim:**
 - I pandehuri E.S., nga babai xxx, i lindur më xxx në xxx, lirohet nga akuza për kryerjen e veprës penale të Detyrimit sipas paragrafit (1) të nenit 267 të KPPK, siç është paraparë në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës Pkr.nr. 218/14 të datës 17 maj 2016;**
- IV. Për pjesën e mbetur, ankesat e avokatit mbrojtës K.K. të parashtruara më 9 dhjetor 2016 dhe ankesa e avokatit mbrojtës B. P. të paraqitur më 8**

dhjetor 2016, të dyja të paraqitura në emër të të pandehurit E.S., refuzohen si të pa bazë dhe Aktgjykimi në pjesët përkatëse, vërtetohet

ARSYETIMI

I. Historiku i Procedurës

1. Më 24 prill 2014, Prokurori i PSRK-së ngriti aktakuzën PPS nr. 467/2009 ku i akuzuari ishte ngarkuar me tri akuza në vijim: *Shtytje për kryerjen e vrasjes së rëndë* në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës (“KPPK”), *Detyrim* në kundërshtim me nenin 267 (1) dhe (2) të KPPK-së, *Dhunim* në kundërshtim me nenin 193 (1) dhe (2) KPPK-së:
2. Seanca dëgjimore fillestare u mbajt më 30 prill 2014.
3. Me aktvendimin e datës 12 qershor 2014, të lëshuar nga Kryetari i Trupit Gjykses, kërkesa e avokatit mbrojtës në emër të të pandehurit **E.S.** për refuzimin e aktakuzës dhe për të shpallur provat si të papranueshme është refuzuar si e pabazuar.
4. Aktvendimi me të cilin refuzohet kërkesa është ankimuar nga avokati mbrojtës në emër të **E.S.** Në aktvendimin e datës 7 gusht 2014, Gjykata e Apelit, e vërtetoi aktvendimin e Kryetarit të Trupit Gjykses që u theksua më lart.
5. Seancat kryesore të shqyrtimit u mbajtën më 31 tetor 2014; 5, 6 10, 14, 19, 20, 21 nëntor 2014; 16 dhjetor 2014; 10, 13, 14, 22, 27, 28, 29 janar 2015; 11 dhe 12 shkurt 2015; 4 dhe 31 mars 2015; 27 dhe 30 prill 2015; 25, 28 dhe 29 maj 2015; 1, 2, 3, 15, 26 qershor 2015; 20, 21, 22 dhe 23 korrik 2015; 17, 18, 19, 20 dhe 21 gusht 2015; 1, 2, 5, 6, 29 dhe 30 tetor 2015; 2, 3, 4, 5, 6, 17, 18 dhe 30 nëntor 2015; 1, 2, 3 dhe 4 dhjetor 2015; 25 janar 2016; 2, 3, 7, 8 dhe 9 mars 2016; 12, 13, 14, 19 2016. Aktakuza e ndryshuar është ngritur më 27 prill 2016, duke marrë parasysh minutazhet e korrigjuara të SMS-ve. Shqyrtimi kryesor vazhdoi më 29 prill 2016 dhe 12 maj 2016.
6. Në pajtim me nenin 541 të KPP që hyri në fuqi më 1 janar 2013, gjykimi u zhvillua sipas dispozitave të Kodit të ri të Procedurës Penale, ndërkaq në lidhje me

veprat penale gjykata e shkallës së parë konstatoi se kodi i vjetër penal ishte më i favorshëm për këtë të pandehur. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës u shpall në publik më 17 maj 2016.

7. Seanca publike para Kolegjit të Gjykatës së Apelit u mbajt më 6 shtator 2017. Kolegji u këshillua dhe votoi më 7 shtator 2017 dhe 19 tetor 2017.

II. Aktgjykimi i shkallës së parë

Duke u bazuar në parimin e ligjit më të favorshëm, neni 3 i KPPK-së, gjykata e shkallës së parë zbatoi të drejtën materiale të KPPK-së së vjetër.

Aktgjykimi (në tekstin e mëtejme: aktgjykimi i kundërshtuar) e shpall të pandehurin fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm në lidhje me pikat 1 dhe 2 të aktakuzës së Prokurorisë Speciale PPS nr. 467/2009 të datës 24 prill 2014, të ndryshuar më 27 prill 2016, si vijon:

Lidhur me akuzën numër një: Vepra penale *Shtytje për të kryer vrasje të rëndë* në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPPK-së, i pandehuri është shpallur fajtor, sepse më 30 gusht 2007, në Prishtinë, në territorin e Kosovës, **E.S.** e shtyri A. B. që të privojë nga jeta T. R., i cili veproi kështu në bashkëkryerje me Rr. A. n, I. A. dhe F. A. në një mënyrë mizore dhe mashtruese dhe për shkak të hakmarrjes së paskrupullt apo motivit tjetër të ulët, përkatësisht për shkak të hakmarrjes personale kundër T. R., një xxx që ka shërbyer në xxx. Para vrasjes, grupi, duke vepruar së bashku, i ndoqi lëvizjet e T.R. për ta gjetur atë.

Lidhur me akuzën numër dy: Gjykata e shkallës së parë e përjashtoi formën e kualifikuar të veprës penale të *Detyrimit* siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 267 të KPPK-së, që ishte theksuar në aktakuzë pasi që kurrë nuk është përmendur se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale më përdorimin e mjetit të rrezikshëm siç kërkohet me këtë paragraf, prandaj gjykata e shkallës së parë e ka shpallur të pandehurin **E.S.** fajtor për veprën penale të *Detyrimit* vetëm sipas paragrafit (1) të nenit 267 të KPPK-së, sepse nga fillimi i vitit 2003 deri në fund të vitit 2004, i pandehuri ka zhvatur shumta të ndryshme të parave dhe në raste të shumta nga pala e dëmtuar **A. I.** Përderisa ajo jetonte në një apartament në zonën e xxx në xxx, ka pasur raste kur i pandehuri kishte kërkuar dhe kishte zhvatur para nga ajo.

Lidhur me akuzën numër tre: Gjykata Themelore e Prishtinës e shpalli të pandehurin **E.S.** të pafajshëm për kryerjen e veprës penale të *Dhunimi* në kundërshtim me Nenin 193 (1) dhe (2) të KPPK-së, siç është theksuar nën **pikën tre** të aktakuzës pasi që nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale.

Për veprën penale të përshkruar në **pikën 1**, në bazë të nenit 3 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës në lidhje me Nenin 24 dhe Nenin 147 (3) dhe (9) dhe Nenin 36 (1) dhe Nenin 37 (2) të KPPK-së, i pandehuri është dënuar me burgim afatgjatë prej 37 (tridhjetë e shtatë) vjetësh;

Për veprën penale të përshkruar në **pikën 2**, në bazë të nenit 3 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës në lidhje me Nenin 267 (1) të KPPK-së, me burgim prej tre (3) vjetësh;

Në bazë të nenit 71 (2) të KPPK-së, kundër të pandehurit **E.S.** është shqiptuar dënimi unik me burgim afatgjatë prej 37 (tridhjetë e shtatë) vjetësh.

Në bazë të nenit 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 i KPP-së, koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri **E. S.**, siç është theksuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nga data 03.01.2014, është llogaritur në lartësinë e dënimit.

Në bazë të nenit 367 paragrafi 2 i KPP-së, masa e paraburgimit kundër **E.S.** është vazhduar deri sa aktgjykimi të merr formë e prerë.

Në pajtim me nenin 453 paragrafi 4 i KPP-së, i pandehuri **E.S.** u lirua nga detyrimi për të kompensuar shpenzimet e procedurës penale.

III. Parashtrësit e palëve

Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit më 24 nëntor 2016. Në emër të tij, avokatët mbrojtës K.K. dhe B. P. parashtruan ankesat e tyre më 9 dhjetor 2016 dhe 8 dhjetor 2016. Të dy ankesat janë parashtruar sipas nenit 478 (4) të KPP dhe në pajtim me nenin 380 të KPP.

Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës K.K.

Avokati mbrojtës në ankesën e saj e kundërshtoi Aktgjykimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit mbi dënimin.

- a) **Shkelja esenciale e dispozitave të kodit të procedurës penale:** Avokati mbrojtës pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në përmbajtjen e tij. Gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe bindëse se cilat fakte janë vërtetuar dhe cilat fakte nuk janë vërtetuar për të dyja akuzat. Ajo më tej thekson se gjykata ka dështuar të vlerësojë saktësinë e provave kundërthënëse. Prandaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka shkelur nenin 384 (1) 1.12) në lidhje me nenin 370 (7) të KPP-së.
- b) **Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike:** Avokati mbrojtës thekson se një numër i konsiderueshëm i elementeve faktike nuk janë vlerësuar në mënyrë të duhur. Provat materiale në favor apo në dëm të të pandehurit nuk janë siguruar sipas nivelit më të lartë profesional. Ekzistimi i veprës penale sipas kualifikimit ligjor të bërë nga prokurori në aktakuzë nuk u materializua kurrë me asnjë provë. Mbrojtja më tej thekson se provat e radhitura në aktakuzë i përshkruajnë veprimet e **A.B. dhe F. A.** Aktakuza dhe aktgjykimi i shkallës së parë përmbajnë vetëm prova në lidhje me personat e lartpërmendur dhe në asnjë mënyrë nuk e lidhin të pandehurin **E.S.** me këtë vrasje.
- c) **Shkelja e kodit penal:** Mbrojtja thekson se pasi që i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale, ai është shpallur fajtor dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të kodit të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e ka zbatuar gabimisht nenin 24 të KPP-së.
- d) **Vendimi mbi dënimin:** Mbrojtja thekson se vendimi mbi dënimin është i padrejtë. Ajo i propozon Gjykatës së Apelit që të aprovojë ankesën e saj.

Përgjigja e Prokurorit të PSRK-së në ankesën e avokatit mbrojtës K.K.:

Prokurori në përgjigjen e tij deklaron se mbrojtja në ankesën e saj nuk i elaboron mjaftueshëm pretendimet e saja se aktgjykimi i kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në përmbajtjen e tij. Mbi pretendimin se aktgjykimi nuk është hartuar në përputhje me nenin 370 (7) të KPP-së, duke shkelur kështu nenin 384 (1) të KPP-së, duke mos i përshkruar faktet dhe rrethanat e veprës penale, prokurori thekson se gjykata ka

shpjeguar tërësisht faktet dhe rrethanat që e mbështesin aktgjykimin fajësues. Në lidhje me pretendimin e mbrojtjes se i pandehuri E.S. nuk do të ulte veten në nivelin e zhvatjes së shumës së parave prej 200-900 euro nga viktima A.I., prokurori përgjigjet se gjatë hetimit prokuroria ka arritur të siguroj prova të mjaftueshme që e mbështesin veprën penale të Detyrimit. Në përgjigjen ndaj pretendimeve të mbrojtjes se policia i shkeli dispozitat e nenit 7 të KPP-së, duke mos dhënë detaje se si i pandehuri E.S. e shtyri A. B. që të vrasë T.R, Prokurori thekson se aspektet vendimtare të aktakuzës janë analizuar dhe sqaruar para gjykatës me prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën se i pandehuri e ka shtytur dhe i ka ofruar shpërblim financiar kryerësit dhe se këto fakte janë vlerësuar qartë nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike se Prokuroria nuk arriti të vendosë lidhjen midis të pandehurit E.S. dhe A. B., Prokurori thekson se mbrojtja në ankesën e saj ka përdorur vetëm deklaratën e A. B. të dhënë para gjykatës ku ai pretendon se e kishte kryer vetë veprën penale dhe nuk ishte shtytur nga E. S.. Në lidhje me këtë, prokurori më tej thekson se provat e paraqitura në gjykatë vërtetuan përtej dyshimit të arsyeshëm se ishte kryer vepra penale e Shtytjes së vrasjes.

Mbi pretendimet se hetimet janë zgjeruar për të përfshirë E. S.. vetëm pas katër muajsh dhe se kjo kohë ishte “e nevojshme për krijimin e pengesave, fabrikimeve, montimeve dhe për shtypjen e dëshmitarëve ...”, prokurori përgjigjet se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme pasi që prokurori është i lirë që të zgjeroj hetimet në çdo kohë kur përmbushet pragu ligjor.

Më tej, në pretendimet se aspekti i Shtytjes në këtë rast është i bazuar në thashetheme dhe pretendime, prokurori përgjigjet se mbrojtja ka anashkaluar numrin e madh të provave që i mbështesin akuzat e përmendura në aktakuzë dhe të përfshira në aktgjykim. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se i pandehuri nuk ka pasur motiv për të kryer këtë veprë penale, prokurori thekson se ngjarjet në lidhje me motivin ishin argumentuar mjaftueshëm gjatë rrjedhës së gjyqimit.

Prokurori thekson se argumenti i mbrojtjes se ky rast është i bazuar në pretendime dhe paragjykime është i papabazë pasi që dëshmitë e administruara janë siguruar në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në KPP.

Në lidhje me dënimin, Prokurori në ankesën e tij konsideron se kohëzgjatja e dënimit me të vërtetë pasqyron rëndësinë e veprave penale të kryera nga i pandehuri dhe është në përputhje me pozitën udhëheqëse të të pandehurit në grup.

Prokurori i bën thirrje Gjykatës së Apelit që të refuzojë ankesën e mbrojtësit si të pabazuar.

Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës B. P.

Avokati mbrojtës ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit mbi dënimin. Argumentet janë të detajuara në ankesat origjinale dhe mjafton thjesht që këtu ti përmbledhim ato.

- a) **Shkelja e kodit penal:** Mbrojtja fillimisht argumenton shkeljen e ligjit penal sipas nenit 385 (1) të KPP-së. Në lidhje me këtë, mbrojtja pretendon se vepra penale e përshkruar në pikën 1 të dispozitivit nuk është vepër penale dhe se akuza për kryerjen e veprës penale të Shtytjes për të kryer vrasje të rëndë është e parëndësishme përveç nëse ka ndonjë veprim konkret që korrespondon me këtë definicion ligjor. Ai më tej thekson se duke respektuar parimin e ligjshmërisë, dispozitivi i aktakuzës që përfshihet në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar duhej të përmbante emërtimin ligjor të veprës penale, kohën dhe vendin e saktë të kryerjes së veprës penale, objektin mbi të cilin është kryer vepra penale dhe instrumentin me të cilin është kryer vepra penale. Bazuar në këtë, mbrojtja thekson se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar nuk është i përpiluar në përputhje me ligjin dhe i mungon përshkrimi konkret i shtytjes. I pandehuri mund të shpallet fajtor për shtytje nëse së pari veprimi i tij përshkruhet në dispozitiv dhe së dyti kjo vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm. Mbrojtja më tej elaboron se gjykata e shkallës së parë e bazoi vendimin e saj mbi provat rrethore dhe se aktgjykimi mund të bazohet në prova rrethore vetëm në raste kur vepra penale është përcaktuar dhe konkretizuar në mënyrë të duhur në dispozitivin e aktgjykimit.
- b) **Shkeljet esenciale të KPP-së:** Mbrojtja thekson se gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 384 paragrafi (2) të KPP-së, duke vepruar në kundërshtim me nenin 314 të KPP-së pasi që ka zgjatur përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Me këtë, gjykata e shkallës së parë ka shkelur të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar

brenda një kohe të arsyeshme, duke pasur parasysh se në rastin në fjalë i pandehuri është privuar nga liria gjatë gjithë rrjedhës së gjykimit.

Mbrojtja më tej thekson se gjykata ka shkelur nenin 369 (1) të KPP-së, që parasheh kohën dhe dorëzimin e aktgjyqimit. Gjukata ka përpiluar dhe dorëzuar aktgjykimin te i pandehuri gjashtë muaj pas shpalljes.

Mbrojtja thekson se gjykata ka shkelur nenin 361 (2) të KPP-së, meqë e ka bazuar konkluzionin e saj plotësisht në përmbajtjen e fjalës përfundimtare të prokurorit dhe nuk i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat veç e veç si dhe provat tjera për të arritur në përfundimin e duhur, siç parashihet me këtë nen.

Mbrojtja argumenton se Neni 10 i KPP është shkelur sepse disa dëshmitarë në këtë rast ishin detyruar të flasin kundër të pandehurit dhe se kjo është zbuluar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në lidhje me këto dëshmi, avokati mbrojtës deklaroi se gjykata e bazoi vendimin e saj në deklaratat e këtyre dëshmitarëve të dhënë prokurorit edhe pse e mohuan në shqyrtimin gjyqësor.

Më tej mbrojtja parashtron se Neni 384 (1) pika 1.8 është shkelur pasi që aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme. Përkatësisht, kontrolli i kryer në xxx më 30 gusht 2007 është kryer pa urdhër verbal të gjykatës nga gjyqtari. Pavarësisht se zyrtarët policorë në shqyrtimin gjyqësor deklaruan se ekzistonte një urdhër verbal nga gjyqtarja **D.H.**, por nuk ka prova apo dëshmi që vërtetojnë një deklaratë të tillë. Prokurori në detyrë në kohën e ngjarjes kritike nuk e kujtoi ekzistimin e një urdhri të tillë verbal, as nuk është shënuar në procesverbalin e kontrollit. Lidhur me këtë, mbrojtja parashtron se janë shkelur dispozitat e Nenit 107 (1) të Kodit të tanishëm procedural dhe të Nenit 246.1 të Kodit të aplikueshëm në momentin e kontrollit, pasi që personat kundër të cilëve u kryen kontrollet nuk ishin njoftuar me të drejtat e tyre për një avokat, kështu që ata nuk ishin në gjendje të ushtronin në mënyrë efektive të drejtat e tyre të parapara me ligj. Më tej, personat të cilët duhet të ishin të pranishëm në kontroll u sollën nga policia tek xxx vetëm gjysmë ore pasi kishte filluar kontrolli. Mbrojtja gjithashtu pohon se sendet e konfiskuara nuk janë ruajtur edhe pas kontrollit të shtëpisë. Prandaj mbrojtja është e mendimit se kontrolli i xxx më 30 gusht 2007 i ka shkelur dispozitat e kodeve të tanishme dhe të mëparshme procedurale, Kushtetutën e Kosovës dhe dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke deklaruar se të gjitha dëshmitë e siguruar nga ky kontroll prandaj, në pajtim me Nenin 111 të KPP së tanishëm, duhet të jenë të

papranueshme dhe si të tilla këto gjësende duhet të përjashtohen nga shkresat e lëndës pasi që gjykata mund të mbështesë vendimin e saj vetëm në provat e pranueshme duke iu referuar Nenit 257 të KPP. Mbrojtja vëren se kërkesa për përjashtimin e këtyre provave është paraqitur nga mbrojtja më 17 gusht 2015.

Lidhur me dëshminë e dëshmitarit D2, mbrojtja parashtron se gjykimi para gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i drejtë në kuptimin se ai kishte shkelur të drejtat e të pandehurit, siç është përcaktuar në Nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, së bashku me Nenin 22, kriteret e përcaktuara në Nenin 6 të KEDNJ nuk janë përmbushur.

Më tej, mbrojtja parashtron se nuk ka dëshmi për të treguar se kushtet e parashikuara në Nenin 224 të KPP për dhënien e statusit të anonimitetit ndaj këtij dëshmitari janë plotësuar, prandaj mbrojtja kërkon nga Gjykata e Apelit që të përjashtojë dëshmitë e dëshmitarit D2 nga dosja e lëndës si të papranueshme.

Në lidhje me provat e marra nga përgjimi telefonik, avokati mbrojtës propozon shpjegime të gjera se pse urdhrat për PTK-në për t'i dhënë gjykatës hartën për datat e caktuara dhe urdhrin e dytë për PTK-në për të ruajtur shënimet e numrave të caktuar të telefonit, siç përcaktohet në faqen 19 të ankesës së tij, janë lëshuar në kundërshtim me ligjin dhe si të tillë, urdhrat dhe zbatimi i tyre çuan në shkelje të rëndë të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës dhe KEDNJ.

Mbrojtja më tej pohon se aktgjykimi i kundërshtuar është në kundërshtim me Nenin 384 (1) pika 1.10 të KPK, pasi e ka tejkalluar fushën e akuzës. Gjykata e bazoi vendimin e saj në përfundimin se shuma prej 63.000 eurosh ishte pranuar nëpërmjet xxx nga N. S. në koordinim dhe në dispozicion të të pandehurit. Gjykata e vërtetoi se këto para i janë dhënë A. B. si shpërblim për vrasjen e T. R.. Në lidhje me këtë mbrojtja argumenton se duke arritur këtë konkluzion, gjykata ka tejkalluar fushën e aktakuzës.

c) Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike: Mbrojtja paraqet dëshmitë e të pandehurit **E.S.** dhe A. B. duke mohuar të jenë shtytur nga i pandehuri.

Në lidhje me pikën një të akuzës, mbrojtja pohon se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **E.S.** kishte motiv për të vrarë T. R.. Lidhur me pikën dy, mbrojtja pohon se nuk ka vlerësim të duhur të provave për të treguar qartë se i pandehuri ka zhvatur para nga A.I. dhe as që ka ekzistuar ndonjë grup i organizuar kriminal.

Sa i përket vendimit për dënimin, avokati mbrojtës deklaroi që dënimet individuale, si dhe dënimi unik nuk janë në proporcion për sa i përket të gjitha fakteve dhe rrethanave që lidhen me dënimin.

Ai i propozoi Gjykatës së Apelit që të modifikojë aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar të pandehurin nga akuzat në pikën 1 dhe 2 të Aktakuzës ose ta kthejë çështjen për rigjykim ose të aplikojë dënim më të butë.

Përgjigja e Prokurorit të PSRK-së për ankesën e avokatit mbrojtës B.P.

Me pretendimin e avokatit mbrojtës se akti i përshkruar në pikën 1 nuk është veprë penale, ashtu si në dispozitiv të aktgjyimit të kundërshtuar mungon përshkrimi konkret i shtytjes, prokurori përgjigjet se kolegji e ka përcaktuar që vepra penale është kryer nga i pandehuri bazuar në provat e grumbulluara.

Në lidhje me shkeljet thelbësore të procedurës penale, përkatësisht shkeljen e Nenit 314 të KPP: shqyrtimi kryesor i zgjatur dhe Neni 369 (1) të KPK: shkelja e dorëzimit të aktgjyimit me shkrim pas gjashtë muajsh, prokurori përgjigjet se një numër i faktorëve duhet të merren parasysh duke përfshirë numrin e madh të dëshmitarëve të dëgjuar dhe arsyet tjera objektive që çuan në periudhën e zgjatur të shqyrtimit gjyqësor si dhe koha e zgjatur për të dhënë aktgjykimin.

Në deklaratën e mbrojtjes se një numër i dëshmitarëve ishte i detyruar të jepte deklaratat, Prokurori deklaroi se kjo çështje është ngritur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe është konsideruar plotësisht nga kolegji dhe se kjo çështje nuk ishte ngritur nga cilido nga dëshmitarët më përpara.

Në lidhje me pretendimin e mbrojtjes për kontrollin, akuza për vendosjen e provave, se janë vjedhur para nga xxx gjatë kontrollit, se kontrolli ishte i paligjshëm, prokurori shpjegon se këto çështje janë ngritur në shqyrtimin gjyqësor dhe ishin hedhur poshtë nga kolegji. Prokurori konsideron se kontrolli është kryer në mirëbesim dhe duke respektuar dispozitat ligjore.

Prokurori në përgjigjen e tij i referohet më tej pretendimit të avokatit mbrojtës se mbrojtja nuk ishte në gjendje t'i adresonte të gjitha pyetjet dëshmitarit D2 pasi ishte e ndaluar nga kryetari i kolegjit. Në lidhje me këtë, prokurori parashtron se kur kemi të bëjmë me dëshmitarë anonim, duhet të merren parasysh dispozitat e veçanta dhe se e drejta e dëshmitarit për jetë dhe integritet fizik është më e rëndësishme se e drejta e

mbrojtjes për të bërë pyetje. Prokurori konsideron se marrja në pyetje e dëshmitarit D2 është kryer në përputhje me dispozitat ligjore.

Më tej, Prokurori i referohet pretendimit të mbrojtjes se operatorët e komunikimit kanë shkelur afatin kohor me të cilin ata duhet të ruajnë të dhënat lidhur me komunikimin elektronik duke deklaruar se e tërë procedura lidhur me analizën e hartografisë, duke përfshirë urdhrat e gjykatës, të dhënat e marra dhe rezultati i analizës mbështeten ligjërisht.

Në pretendimin e mbrojtjes se gjykata e ka tejkalluar qëllimin e aktakuzës dhe se kjo është bërë nga gjykata kur ka përcaktuar se pjesa e parave të marra nëpërmjet xxx nga N.S. është përdorur për të financuar vrasjen e T. R. dhe se një pjesë është përdorur për të rindërtuar shtëpinë familjare të A.B. dhe se kjo nuk është përmendur në aktakuzë por është gjetur nga gjykata, Prokurori konsideron se mbrojtja e ka kuptuar gabimisht konceptin e tejkalimit të fushëveprimit të aktakuzës siç parashihet në Nenin 384 (1. 10) të KPK dhe se gjykata nuk është e lidhur nga përmbajtja e aktakuzës. Prokurori thekson se është detyra e gjykatës të përmendë gjetjet e reja gjatë shqyrtimit gjyqësor, prandaj Prokurori konsideron se janë marrë të gjitha masat për të siguruar të gjitha aspektet e faktit të akuzuar në aktakuzë.

Në lidhje me pretendimin e mbrojtjes për vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, prokurori në përgjigjen e tij deklaron se mbrojtja po bën spekulime me qëllim që dëshmitë të kenë një rëndësi tjetër që nuk kanë mbështetje në procedurën e provave.

Prokurori thotë se nuk ka dokument për të mbështetur ekzistencën e një huaje në mes N.A. në njërën anë dhe N. S. dhe A.E. në anën tjetër. Kjo çështje ishte ngritur dhe marrë parasysh gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori në përgjigjen e tij deklaron se dëshmitarët dhanë deklaratat të sakta dhe të detajuara për detyrimin e përdorur nga i pandehuri.

Sa i përket vendimit mbi dënimet penale të kundërshtuara në ankesën e mbrojtjes, Prokurori deklaron se dënimi me të vërtetë pasqyron rëndësinë e veprave penale të kryera nga i pandehuri.

Prokurori propozon që të hedhet poshtë ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës si të paafatshme sipas Nenit 380 të KPP ose të hedhë poshtë ankesën e të pandehurit si të pabazuar.

Parashtrësja e Prokurorit të Apelit

Prokurori i Apelit, në kërkesën e tij, *ex officio*, i referohet kufizimit ligjor të veprës penale nën akuzën 2: Detyrimi sipas Nenit 267 (1) të KPK, ku thuhet se i pandehuri nuk mund të ndiqet për këtë vepër penale sipas paragrafit (1) pasi ngjarja ndodhi në fillim të vitit 2003 deri në fund të vitit 2004.

Në lidhje me pretendimet se kontrolli në xxx ishte i paligjshëm për shkak se ishte kryer pa urdhër dhe në mungesë të personave të përcaktuar në Nenin 111 (1.6) të KPP, Prokurori i Apelit thekson se procedura e kontrollit duhet të vlerësohet në pajtim me Kodin e Procedurës Penale në fuqi në vitin 2007. Sa i përket faktit nëse provat e siguruar në mënyrë të ligjshme janë të pranueshme për shqyrtimin gjyqësor, ai duhet të vlerësohet në bazë të KPP aktual si ligj i zbatueshëm për tërë procedurën penale, nëse nuk ka përjashtim.

Në lidhje me statusin e dëshmitarit anonim D2, Prokurori i Apelit thekson më tej se Kryetari i Kolegjit e adresoi këtë çështje gjatë seancës së 2 Qershorit 2015, kur shpjegoi rreziqet me të cilat dëshmitari mund të jetë i ekspozuar nëse dëshmon në një seancë të hapur dhe përsëri në seancën e datës 20 gusht 2015, gjykata shpjegoi pse e kishte konsideruar se dëshmitari D2 ishte nën rrezik serioz, pse dëshmia kishte qenë relevante dhe pse dëshmitari ishte konsideruar i besueshëm.

Anonimiteti i dëshmitarit D2 nuk pengon të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë. Duke iu referuar Nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, Prokurori i Apelit thekson se mbrojtja kishte të drejtë të shqyrtojë dy herë dhe në tërësi dëshmitarin D2.

Po ashtu, nuk ka shkelje të Nenit 262 (3) të KPP që e ndalon Gjykatën të bazojë aktgjykimin e fajësisë vetëm ose në nivelin e vendosur mbi një deklaratë të dhënë nga dëshmitari anonim sepse Gjykata në Aktgjykimin e saj i kushtoi vëmendje të veçantë për të vërtetuar deklaratën e dëshmitarit D2 me prova të tjera.

Sa i përket pranueshmërisë së të dhënave të hartografisë, Prokurori i Apelit thekson se kufizimi i kohës së ruajtjes së të dhënave nuk do të thotë që nëse të dhënat ruhen për një periudhë më të gjatë kohore, do të ndalonte autoritetet të konsiderojnë informacionin si dëshmi.

Prokurori i Apelit i përgjigjet pretendimit të mbrojtjes se disa dëshmitarë janë kërcënuar dhe detyruar të flasin kundër të pandehurit duke deklaruar se shumica e dëshmitarëve të emëruar nga mbrojtja nuk janë relevant pasi që ata i referohen pikës 2 të aktakuzës që

duhet të hedhet poshtë për shkak të parashkrimit. Ajo më tej thekson se gjykata është mbështetur vetëm në provat e dhëna në shqyrtimin kryesor.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se gjykata e ka tejkalluar qëllimin e aktakuzës / shkelja e Nenit 384 (1) 1.10) të KPK kur arriti në përfundimin se **E.S.** e financoi vrasjen e T.R., Prokurori i Apelit thekson se ndërsa gjykata është e detyruar nga akuza sipas Nenit 360 (1) të KPP, nuk është e detyruar nga evoluimi i fakteve që dalin gjatë shqyrtimit gjyqësor, çka është gjithashtu funksioni parësor i gjykatës.

Prokurori i apelit thekson më tej se aktgjykimi jep fakte gjithëpërfshirëse vendimtare sipas Nenit 370 dhe 365 të KPP.

Në lidhje me shkeljen e Nenit 314 të KPP, se shqyrtimi gjyqësor e tejkaloj maksimumin e afatit të parashikuar në këtë Nen dhe shkeljen e Nenit 369 (1) të KPP dhe se aktgjykimi i kundërshtuar është hartuar dhe është dorëzuar gjashtë muaj pas shpalljes së tij, Prokurori i Apelit parashtron se argumentet e paraqitura nga mbrojtja janë të vlefshme. Megjithatë, ligji nuk ofron asnjë mjet për korrigjimin e kësaj shkeljeje. Në lidhje me këtë, Prokurori i Apelit e fton GjA që të konsiderojë dhënien e kompensimit të pandehurit duke deklaruar deri në tre muaj dënimin siç është caktuar tashmë.

Në pretendimin e mbrojtjes se gjykata e ka shkelur Nenin 383 (1.3), siç parashikohet në Nenin 386 të KPP, Prokurori i Apelit thekson se mbrojtja nuk e ka treguar se gjykata e ka bërë një gabim të paarsyeshëm në lidhje me gjetjet e tij ose përfundimet e fakteve. Procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor tregojnë se gjykata i ka kushtuar vëmendjen e duhur dëshmimeve të mbrojtjes, që do të thotë se gjykata nuk i ka injoruar dëshmitë shfajësuese.

Për sa i përket pretendimit të mbrojtjes për shkeljen e Nenit 387 të KPP se dënimi i unik dhe ndëshkimi individual nuk janë në proporcion me rrethanat e rastit, Prokurori i Apelit i propozon GjA që të vlerësojë nëse ka pasur shkelje të Nenit 385 (1.5) të KPP. Ajo konsideron se nuk ka shkelje të dënimit unik megjithatë ajo pajtohet me argumentet e mbrojtjes mbi burgimin afatgjatë prej 37 vjetësh.

Prokurorja e Apelit në kërkesën e saj argumenton se gjykata e ka liruar të pandehurin nga detyrimi për të kompensuar shpenzimet e procedurës penale pa dhënë asnjë informacion mbi gjendjen e tij financiare. Duke iu referuar dispozitave të KPP, ajo i propozon GjA të modifikojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe t'i caktojë të pandehurit shpenzimet e procedurës.

Prokurorja e Apelit i propozon Gjykatës së Apelit që të modifikojë aktgjykimin e kundërshtuar në përputhje me Nenet 398 (1.4) dhe 402 (3) të KPP duke hedhur poshtë pjesën e aktgjykimit të kundërshtuar që i referohet pikës 2; t'ia caktojë shpenzimet e procedurës penale, të rivlerësojë dënimin konkret për akuzën 1, të hedh poshtë ankesën e avokates mbrojtëse K. K. si të papranueshme ose të pabazuar dhe të hedhë poshtë pjesën e mbetur të ankesës së B.P. si të pabazuar.

Cështjet paraprake procedurale

Kolegji i Gjykatës së Apelit e mbajti një seancë në këtë lëndë më 6 shtator 2017; dhe mbajti këshillime më 7 shtator 2017 dhe 19 tetor 2017.

Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e Kolegjit

Gjykata e Apelit është gjykata kompetente për të gjykuar mbi ankesat e palëve kundër aktgjyqimeve të shkallës së parë, në pajtim me Nenet 17 dhe 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr.03/L-199).

Në pajtim me Ligjin mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe 05/L-103, rasti konsiderohet si 'rast në vazhdim' dhe rrjedhimisht bie nën juridiksionin dhe kompetencën e gjyqtarëve të EULEX-it, në përputhje me Nenet 1, paragrafët 1 dhe 2 dhe 3, paragrafi 5, Ligji 05/L-103 me formulimin aktual të ndryshuar.

Përbërja e kolegjit me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it, të kryesuar nga një gjykatës i EULEX-it në këtë rast, bazohet në Vendimin KGJK, KGJK, nr. 126/2017 të datës 27 prill 2017;

Gjetjet mbi meritat:

Kolegji thekson që gjykata e shkallës së parë e ka shpallur të pandehurin **E.S.** fajtor në lidhje me veprën penale të Shtytjes për të Kryer Vrasje të Rëndë në kundërshtim me Nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPK dhe veprën penale të Detyrimit vetëm në bazë të paragrafit (1) të Nenit 267 të KPK dhe të pafajshëm për veprën penale të Dhunimit në kundërshtim me Nenin 193 (1) dhe (2) të KPK siç është specifikuar nën pikën tre të aktakuzës pasi që nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale.

Kolegji së pari do të diskutojë akuzën nën pikën e parë, domethënë veprën penale të Shtytjes për të Kryer Vrasje të Rëndë në kundërshtim me Nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPK.

Pika një:

Shkelja e Nenit 384 (1) 1.12) në lidhje me Nenin 370 (7) të KPPK dhe Nenit 365 të KPPK:

Siç është përmendur tashmë, avokatët mbrojtës argumentojnë se Aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të KPPK. Ata pohojnë se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor në përmbajtjen e tij.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të shkresave të lëndës dhe Aktgjykimit të kundërshtuar, Kolegji i Gjykatës së Apelit pajtohet se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban shkelje esenciale të dispozitave të KPPK, përkatësisht shkelje të Nenit 384 (1.12) të KPPK në lidhje me Neni 370 (4) dhe Neni 365 (1.1) ibid. Ky i fundit parasheh që "në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata duhet të deklarojë: 'veprën për të cilën ai ose ajo është shpallur fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën kriminale të veprës së kryer dhe faktet dhe rrethanat në të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal'.

Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar nuk përmban përshkrimin faktik të veprës penale, e cila është cilësuar si Shtytje për të kryer vrasje të rëndë. Aktgjykimi jep përshkrim të përgjithshëm të veprimtarisë kriminale të grupit të pretenduar kriminal të **E.S.**, dhe vetvetiu jep përshkrimin e vrasjes së rëndë e cila është kryer nga **A. B.**, por në asnjë mënyrë nuk saktëson veprimin apo veprimet e të pandehurit se si ai, **E. S.**, e shtyri **A.B.** për të vrarë **T.R.**. Aktgjykimi fjalë për fjalë e përsërit aktakuzën dhe kjo e fundit nuk ka një përshkrim të fakteve që mund të përfshihen në nëntitullin "Shtytja për të kryer vrasje të rëndë". Për këtë çështje, ky Kolegj vëren se sipas Nenit 241 (1) 1.15) të KPPK-së aktakuza duhet të përmban 'rrethanat e nevojshme për përcaktimin e veprës penale me saktësi'. Kjo kërkesë nuk është plotësuar. Dhe ky lëshim është dyfishuar në Aktgjykim.

Konkretisht, i pandehuri **E. S.** është shpallur fajtor si dhe është akuzuar për veprën penale Shtytje për të kryer vrasje të rëndë në kundërshtim me Nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPPK, por kjo nuk është formuluar në anën objektive çfarë është ajo që bëri i pandehuri e cila mund të kualifikohet si Shtytje e **A.B.** për ta vrarë **T. R.**. Nga pikëpamja teorike, një krim karakterizohet me pjesët e tij objektive dhe subjektive. Objektivist krimi

përshkruhet si një akt, një manifestim njerëzor. Është gjithmonë një veprim i paramenduar dhe i qëllimshëm, i shkaktuar nga individi për të përshtatur realitetin ekzistues me nevojat e tij ose të saj. Akti mund të shfaqet në dy forma themelore, veprim ose mosveprim. Pa sqarime të mëtejshme mbi shpjegimet teorike nga ligji penal material, Kolegji i referohet rastit konkret dhe pohon se thjesht dikush nuk mund të akuzohet dhe të dënohet për Shtytje për kryerjen e një vrasje, pa dhënë ndonjë përshtkrim të duhur për atë cilat akte (veprime ose mosveprime) ka kryer ky person i caktuar për të shtytë ekzekutuesin fizik që të kryejë vetë vrasjen.

Për këtë çështje, dhe me qëllim të sqarimit të qëndrimit në dispozitiv, pa hyrë në vërtetimin e gjendjes faktike (të cilin do ta vlerësoj trupin gjykues), Kolegji i Gjykatës së Apelit e sheh të nevojshme të shpjegoj elementet e veprës penale në rast. Në mënyrë që të bej shtjellimet e tij të përshtatshme me kontekstin e Kosovës, Kolegji i referohet Komentarit të Kodit Penal të Kosovës (autorë Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, mars 2014). Lidhur me Nenin 32 të KPRK-së (që korrespondon me Nenin 24 të KPPK-së), Komentari sqaron se shtytja është një mënyrë e veprimit për të krijuar ose forcuar qëllimisht vendimin e një personi tjetër për të kryer një akt të caktuar kriminal. Nga kjo rrjedh se Shtytja mund të kryhet duke krijuar idenë për kryerjen e aktit kriminal dhe forma tjetër është forcimi i idesë ekzistuese për të kryer një akt të caktuar kriminal. Teoria dhe praktika gjyqësore demonstrojnë se shtytja mund të kryhet nga një akt për të bindur personin tjetër të kryejë veprë penale duke i dhënë ose premtuar një përfitim material, ose duke e lutur, duke e kërcënuar, duke i dhënë udhëzime etj për të kryer veprën e caktuar penale të përmendur kundër një personi të caktuar ose grupi njerëzish. Kjo listë nuk është përfundimtare, por në çdo rast shtytja është një lloj i aktit të pjesës së shtytësit për të bindur ekzekutuesin fizik të krimit për të kryer krimin.

Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë përshtkrim të mundshëm, as fakte të rëndësishme që tregojnë veprën penale të kryer nga i pandehuri. Në një lloj mënyre supozuese në pjesën e saj argumentues, Aktgjykimi sugjeron se ekzekutuesi fizik dhe i pandehuri ishin në një marrëdhënie të nënshtrimit absolut, ku **E.S.** do të lëshojë një urdhër dhe **A. B.** në mënyrë rigoroze do të ndjekë atë pa e kundërshtuar atë, edhe nëse kjo do të thotë që ai të vras dikë. Nga ana tjetër Aktgjykimi aludon se kjo ishte një lloj shtytje monetare, financiare, ku **A. B.** e vrau **T. R.** në mënyrë që të kompensohen financiarisht në formën e **E.S** kinse duke paguar për ndërtimin e shtëpisë së re të familjes **B.**

Asnjë nga këto hipoteza të mundshme nuk janë konstatuar shprehimisht as në aktakuzë as në Aktgjykim, i cili sipas mendimit të Kolegjit të Gjykatës së Apelit reflekton negativisht mbi vlerësimin e duhur të provave sepse nuk është e qartë cilin përshtkrim faktik gjykata e konstatoj si të provuar dhe në bazë të cilave prova. Me fjalë të tjera, nuk është e qartë se

çfarë është ajo që Gjykata Themelore konstatoi të jenë faktet e krimit, dhe nëse ishte ajo një lloj varësie social e B. që e shtyri atë të ndjek në mënyrë rigoroze secilin urdhër të dhënë nga S. pa kundërshtim edhe nëse kjo do të thotë të kryej një vrasje të rëndë, apo nëse kjo ishte një inkurajim i pastër financiar në të cilin S. “bleu” B., dhe ky i fundit e kreu krimin për shpërblim. Dhe në atë aspekt, nëse ishte njëra ose tjetra cila ishte prova që e provoi atë.

Duke marrë parasysh seriozitetin e aktakuzës dhe se krimi mund të përcaktohet vetëm me elementet e tij objektiv dhe subjektiv, aktgjykimi fajësues gjithmonë duhet të tregojë qartë nga ana objektive se cili ishte akti i kryer, që cilësohet si krim. Aktgjykimi nuk mund t’i referohet thjesht një Neni të drejtës materiale penale pa përshkruar faktet që përbëjnë vetë krimin. Kualifikimi në të drejtën materiale nuk zëvendëson rrethanat faktike të krimit.

Duke ndjekur arsyetimin e mësipërm dhe duke u kufizuar nga shkeljet esenciale absolute të përcaktuara në Nenin 384 (1) 12 të KPPK-së të konstatuara në aktgjykimin e kundërshtuar në rastin në fjalë, Gjykata e Apelit kufizohet të veprojë në pajtim me Nenin 403 të KPP-së meqë gabimet e bëra nga gjykata e shkallës së parë nuk mund të korrigjohen vetëm duke ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar. Prandaj, Pika një e rastit, përkatësisht vepra penale Shtytje për të kryer vrasje të rëndë në kundërshtim me Nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPPK i është kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjatë rigjyimit Gjykata Themelore do të ndërmer masa për të sqaruar aktakuzën sa më shumë që të jetë e mundur, dhe kur të merr Aktgjykimin e saj (pa marrë parasysh nëse do të jetë vendim fajësues ose lirues) duhet të thotë qartë se cilat janë elementet e krimit me të cilat i pandehuri është akuzuar.

Përveç kësaj, Kolegji i Gjykatës së Apelit thekson pikat kontestuese të mëposhtme që duhet të shqyrtohen gjatë rigjyimit, përkatësisht: besueshmëria e deklaratës së dëshmitarit D2 dhe vlera e saj provuese, ligjshmëria e bastisjes në xxx, dhe së fundi pranueshmëria dhe vlera provuese e dokumenteve nga PTK-ja dhe të dhënat përkatëse të hartografisë.

I ashtuquajturit Dëshmitari D2 është anonim dhe është i vetmi dëshmitar që lidh **E. S.** me kryerjen e veprës penale të Shtytjes, dhe gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar deklaratat e tij vendimtare për të shpallur të pandehurin fajtor për një vepër të tillë të rëndë penale. Në rigjykim gjykata e shkallës së parë do të vlerësojë saktësinë e deklaratave të dëshmitarit D2, dhe do të vërtetojë nëse kjo deklaratë është mbështetur nga ndonjë dëshmi tjetër për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E. S.** shtyri A. B. për të kryer një vrasje të rëndë. Gjykata e shkallës së parë duhet të thotë në mënyrë të qartë në çfarë

forme është manifestuar shtytja ose jo, dhe bazën provuese për njërin ose konkluzionin tjetër.

Aktgjykimi i kundërshtuar nuk ofron argumente të mjaftueshme për të mbështetur konkluzionin e Gjykatës Themelore se procedura e kryer gjatë kontrollit në xxx i ka ndjekur urdhrat e kodit të procedurës penale në atë kohë. Nuk është vërtetuar nëse është marrë një urdher verbal, që është një mundësi sipas Nenit 245 (3) të KPPPK-së. Përveç kësaj, Gjykata Themelore pranoi se asnjë raport nuk i ishte dërguar post faktum, as prokurorit publik as gjyqtarit të procedurës paraprake siç kërkohet në Nenin 245 (6) të KPPPK-së, dhe pavarësisht kësaj gjykata pranoi se kjo nuk ishte “bazë për papranueshmëri sipas Nenit 246 të KPP-së së vjetër”. Në këtë drejtim, gjatë rigjykimit, gjykata e shkallës së parë do të duhet të rivlerësojë nëse kryerja e kontrollit ishte e bazuar ligjërisht dhe në përputhje me dispozitat e KPPPK.

Për më tepër, gjykata e shkallës së parë nuk e arsyetoi pranueshmërinë e dokumenteve, që supozohet se kanë ardhur nga kompania e telekomunikacionit (PTK). Thuhet jo, por nuk është dhënë një arsyetim i qartë për këtë shpjegim. Gjatë rigjykimit gjykata e shkallës së parë do të duhet t’i përgjigjet këtij pretendimi dhe lidhur me atë të vlerësoj përsëri nëse të dhënat, nëse kanë ardhur nga PTK, janë të pranueshme në kontekstin e afateve të mundshme për ruajtjen e këtyre të dhënave. Këtu i është referuar Ligjit për komunikime elektronike (Ligji Nr. 04/L-109), 4 tetor 2012 dhe Ligjit për Telekomunikacion (Ligji Nr. 2002/7) 12 maj 2003. Vlerësimi duhet të fillojë me atë se cila do të jetë korniza e aplikueshme ligjore në kohën e kryerjes së krimit, dhe nëse në çfarë mase afatet kohore të përcaktuara në Nenin 68 të Ligjit për komunikime elektronike zbatohen për të dhënat që janë ruajtur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse zbatohen fare. Pas vlerësimit të pranueshmërisë dhe vlerësimit të vlerës provuese të dokumenteve, gjykata duhet t’i referohet ekspertizës teknike (lidhur me hartografinë) për të vërtetuar qartë faktet relevante. Në përmbledhje, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë kredibilitetin e dëshmitarit D2 dhe vlerën provuese të deklaratave të tij të dëshmitarit; pranueshmërinë e të dhënave të PTK-së; vlerën provuese të këtyre dokumenteve; të dhënat përkatëse hartografike; pranueshmërinë e provave të siguruara gjatë kontrollit në xxx si dhe vlerën provuese të secilës pjesë të provave relevante për qëllimin e akuzimit të të pandehurit për Shtytje.

Së fundi, dhe për të vërtetuar faktet vendimtare të rastit, gjatë rigjykimit gjykata e shkallës së parë do të duhet të dëgjojë si dëshmitar Rr. A. n, i cili është i pandehur në një çështje penale të veçantë për akuzën Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së vrasjes së T.R.. Rasti i Rr. A. ishte në pritje në Gjykatën Themelore në Prishtinë (i është referuar Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në rastin PAKR.nr.140/16 nga 5 maji 2016).

Pika dy:

Kolegji i Gjykatës së Apelit pajtohet me Prokurorin e Apelit se vepra penale Detyrimi sipas paragrafit (1) të Nenit 267 të KPPK ka arritur parashkrimin.

Më saktësisht, i pandehuri **E.S.** ishte akuzuar në Aktakuzën e Prokurorisë Speciale PPS nr. 467/2009 të datës 24 prill 2014, të ndryshuar më 27 prill 2016 për veprën penale Detyrim në kundërshtim me Nenin 267 (1) dhe (2) të KPPK. Gjykata e shkallës së parë përjashtoi formën e kualifikuar të veprës penale të Detyrimit siç parashihet në paragrafin 2 të Nenit 267 të KPPK-së, që ishte detajuar në aktakuzë pasi që asnjëherë nuk është përmendur se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale duke përdorur instrument të rrezikshëm që kërkon ky paragraf, prandaj gjykata e shkallës së parë e ka shpallur të pandehurin **E. S.** fajtor për veprën penale Detyrim vetëm në bazë të paragrafit (1) të Nenit 267 të KPPK-së. Ky akt kriminal pretendohet se është kryer nga fillimi i vitit 2003 deri në fund të vitit 2004. Për këtë vepër penale, Neni 267 paragrafi (1) i KPPK parashikon që dënimi të jetë më së shumti pesë vjet burgim.

Neni 90 paragrafi (1) i KPPK-së parashikon që ndjekja penale nuk mund të fillojë pas:

“Pesë vjet nga kryerja e një vepre penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre vjet (Neni 90 paragrafi (1) (4) i KPPK-së).

Në pajtim me Nenin 91 të KPPK, afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon ditën kur është kryer vepra penale. Në rastin në fjalë, vepra e pretenduar penale është kryer nga fillimi i vitit 2003 deri në fund të vitit 2004. Për veprën penale në vijim, parashkrimi fillon nga akti i fundit të saj, i cili në këtë rast do të ishte 31 dhjetor 2004.

Është e vërtetë që çdo veprim i ndërmarrë me qëllim të ndjekjes e ndërpret periudhën e parashkrimit, por ligji cakton një parashkrim absolut për ndjekje penale në rast kur afati i parashkrimit kalon dy fish, domethënë se pavarësisht nga veprimet e autoriteteve, ndjeka penale ndalohet pas kësaj periudhe kohore. Neni 90 Paragrafi (1) 4) i KPPK-së duhet të lexohet lidhur me nenin 91 paragrafin (6) të KPPK-së që thotë se:

‘Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut për ndjekje penale)’.

Meqenëse akti i fundit i veprës penale pretendohet se është kryer me 31 dhjetor 2004, parashkrimi absolut për ndjekje penale është arritur më 31 dhjetor 2014, kështu që veprimet sipas paragrafit (1) të Nenit 267 të KPPK-së janë ndaluar nga ndjekja penale për shkak të parashkrimit absolut madje edhe gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor që filloi para gjykatës së shkallës së parë më 31 tetor 2014.

Dispozitat e ligjit penal të Kosovës, siç u shpjegua më sipër, do të mjaftojnë për të mbështetur konstatimin se ndjekja e një vepre të caktuar penale ka arritur parashkrimin dhe e ndalon ndjekjen. Megjithatë, standardet ligjore ndërkombëtare që i përkasin të drejtave dhe lirive themelore të njeriut kërkojnë vlerësimin e fakteve të rastit sa herë që do të ekzistojnë kushtet për lirim. Në këtë mënyrë, Gjykata siguron një shkallë më të lartë të mbrojtjes dhe pohimin e prezumimit të pafajësisë në pajtim me Nenin 6 (2) të KEDNJ-së.

Pas vlerësimit të kujdesshëm të rastit, Kolegji konstaton se nuk ka prova për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale të Detyrimit sipas paragrafit (1) të Nenit 267 të KPK, siç është specifikuar në Aktgjykimin e kundërshtuar.

Kjo akuzë bazohet kryesisht në dëshminë e dëshmitares A.I. Ajo dëshmoi para trupit gjykues më 27 prill 2015 në cilësinë e palës së dëmtuar dhe të dëshmitarit kryesor, siç thuhet në Aktgjykimin e kundërshtuar. Në shqyrtimin gjyqësor ajo ka deklaruar se nuk kishte probleme personale me të pandehurit **E. S.**, duke devijuar kështu nga dëshmia të dhënë para prokurorit më 25 tetor 2007, kur deklaroi se i pandehuri zhvati të holla prej saj në raste të ndryshme. Kur u pyet përse dëshmia e saj ishte ndryshe, ajo pohon se ishte deklarate e momentit dhe se ishte prekur nga tragjedia meqë intervista ndodhi menjëherë pas vrasjes së T.R.. Në lidhje me këtë, trupi gjykues i shkallës së parë konstatoi se arsyet për ndryshimin e dëshmisë nuk janë të besueshme dhe prandaj e bazoi Aktgjykimin fajësues në dëshminë e A.I. të dhënë në fazën paraprake.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se neni 361 i KPP në paragrafin 1 thotë qartë se gjykata do ta bazojë Aktgjykimin e saj vetëm mbi faktet dhe provat e shqyrtuara në shqyrtimin kryesor. Është e qartë se gjykata e shkallës së parë nuk e bazoi Aktgjykimin e saj mbi provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në lidhje me piken dy të akuzës.

Ligjvënësi parashikon që është në diskrecionin e gjykatës për të vlerësuar provat si të provuara, por Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar. (Neni 361 (2) i KPP). Sa i përket ‘në lidhje me sendet tjera të provave’, gjykata e shkallës së parë përsëri gabimisht e bazoi Aktgjykimin e saj në dëshminë paraprake të **M.dhe M.I.**

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave në lidhje me Piken dy, Kolegji i Gjykatës së Apelit konstaton se nuk ka prova për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.S.** ka kryer veprën penale të Detyrimit sipas paragrafit (1) të Nenit 267 të KPK-së, dhe për këtë arsye e liron të pandehurin për akuzën në pikën dy të Aktgjykimit të kundërshtuar.

Paraburgimi

Në lidhje me masën e paraburgimit, ky është objekt i një Aktvendimi të veçantë të Gjykatës së Apelit.

Vërejtjet e përmbyllëse

Në lidhje me aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës Themelore, Kolegji i Gjykatës së Apelit, për arsyet e shtjelluara më lartë, pjesërisht i miraton ankesat e paraqitura nga avokatja mbrojtëse K.K. dhe B. P të paraqitura në emër të të pandehurit **E.S.** në lidhje me Piken një.

Kolegji konstaton se është i nevojshëm një shqyrtim i ri gjyqësor para Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Lidhur me piken dy, Kolegji i Gjykatës së Apelit e ndryshon Aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar të pandehurin, siç saktësohet në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë do të shqyrtojë të gjitha pikat e diskutueshme të përshkruara më lart dhe do të merr Aktgjykimin e saj duke ndjekur rekomandimet e numëruara më lart. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë do të dëgjojë si dëshmitar Rr. A.

Aktgjykimi i kundërshtuar në lidhje me pikën 3 është konfirmuar.

I bërë në Anglisht, gjuhë e autorizuar.

Kryetarja e Kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtar i Kolegjit

Mejreme Memaj

Gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Kosovës

Anëtar i Kolegjit

Anna Adamska Gallant

(Ka ndarë mendimin)

Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtëse

Vjollca Kroci - Gerxhaliu
Këshilltare Ligjore EULEX

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS

PAKR 1/2017

19 tetor 2017